



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**A.nr.71/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Hajriz Hoti - kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Bujar Muzaqi - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik, Nova Demokratska Stranka-NDS, me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Vendimi Nr.01/84-2025, për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, të datës 14.01.2025, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 22.01.2025, merr këtë:

**V E N D I M**

**HEDHET** e pasafatshme ankesa Anr.71/2025 i datës 20.01.2025, i parashtruar nga subjekti politik, Nova Demokratska Stranka-NDS, me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.01/84-2025, për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, të datës 14.01.2025, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025.

**A r s y e t i m**

PZAP më datë 20.01.2025, ka pranuar ankesën Anr.71/2025 parashtruar nga Nova Demokratska Stranka-NDS, me seli në Prizren për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikë e Kosovës, ka paraqitur ankesë në Panelin Zgjedhorë për Ankesa dhe Parashtresa kundër vendimit të KQZ-së, 01/84 -2025 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës të datës 14 janar 2025, të marrë për zgjedhjet e ardhshme më 9 shkurt të vitit 2025, ku numri i anëtarëve (komisionerëve) të emëruar të këshillave zgjedhore për Partinë e Re Demokratike (NDS) është përgjysmuar në bazë të zgjedhjeve të mëparshme, edhe pse ne jemi parti parlamentare.

Më tutje parashtruesi i ankesës thekson, përshkrimin e detajuar të shkeljes, me vendim të KQZ-së, NDS-së iu dha një numër i reduktuar i anëtarëve të këshillave zgjedhore në krahasim me

partitë e komunitetit shumicë, të cilave iu caktua numri maksimal i anëtarëve. Një parregullsi edhe më e madhe është në faktin se partitë e reja të regjistruara dhe kandidatët e pavarur morën pothuajse të njëjtin numër anëtarësh të këshillave zgjedhore si NDS, dhe se në këtë mënyrë është shkelur parimi i barazisë dhe drejtësisë së procesit zgjedhor. Tutje në ankesë theksohet se arsyet që besojmë se ka ndodhur një shkelje: Vendimi i KQZ-së bie ndesh me parimet e Rregullores së Zgjedhjeve nr. 11/2024, veçanërisht me dispozitat: neni 3, paragrafi 1, ku thuhet: KQZ-ja fton subjektet e certifikuara politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit nacionale të propozojnë një (1) anëtar për KZ. Neni 3, pika 2, ku thuhet: KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësim të drejtë në KZ, për të gjitha komunitetet, bazuar në: 2.1. Numrit të ndryshëm të popullsisë brenda komunës, 2.2. numrin e votave të subjekteve politike të çdo komuniteti, në nivel vendi dhe në nivel komune.

Sipas parashtruesit të ankesës në bazë të Vendimit është shkelur plotësisht rregulli i përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë, dhe sipas Vendimit të lartpërmendur të KQZ-së, edhe në një komunë multietnike siç është Prizreni, ku komuniteti boshnjak është i dyti për sa i përket popullsisë, ka një numër shumë të vogël anëtarësh të këshillit zgjedhor përpara komunitetit boshnjak. Gjithashtu, në zonat etnike boshnjake (Zhupa dhe Podgora në komunën e Prizrenit dhe Restelica në komunën e Dragashit), 90% e anëtarëve të këshillit zgjedhor janë nga partitë shqiptare. E cila cenon të drejtat e garantuara me Kushtetutë për përfaqësim të komuniteteve jo shumicë.

Parashtruesi i ankesës kërkon që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të urdhërohet që ta rrit numrin e anëtarëve të nominuar të këshillave zgjedhore për NDS-në, veçanërisht në komunën e Prizrenit dhe Dragashit dhe të përcaktohet renditja e anëtarëve të emëruar të këshillave zgjedhore në bazë të rezultateve të arritura në zgjedhjet e mëparshme. Ne besojmë se është e padrejtë që anëtarët e emëruar të NDS-së të vendosen vetëm për të plotësuar formën, në vende ku NDS nuk ka vota.

Si provë ka bashkangjitur, një kopje të vendimit të KQZ-së për caktimin e anëtarëve të këshillit zgjedhor.

Më datë 20.01.2025, PZAP-i, e njoftoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 20.01.2025 në ora 13:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 20.01.2025, të paraqitur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) theksohet se në vendimet e plotfuqishme të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) për A.nr 17/25, A.nr 18/25, A.nr 20/25, A.nr 19/25 të datës 11.01.2025 dhe A.nr 26/25 e datës 13.01.2025 e ka kthyer në rivendosje vendimet e KQZ-së: Vendimi Nr.01/30-2025, i datës 08.01.2025 për Miratimin e Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) dhe Vendimi Nr.01/31-2025, i datës 08.01.2025 i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht. Duke pasur parasysh se vendimet e PZAP-së janë të detyrueshme për tu zbatuar, KQZ sipas nenit 77 paragrafi 5 i ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në mbledhjen qarkulluese të mbajtur me datën 14.01.2025, ka miratuar përbërjen e

Ekipeve të numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64 dhe nenin 101 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 20 paragrafi 1 dhe 4 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit, si dhe neni 3 paragrafi 1,2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 dhe të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve.

Më tutje në përgjigje në ankesë theksohet se KQZ, gjatë ndarjes së vendeve përtej neneve të lartcekura është angazhuar që gjatë shqyrtimit dhe vendimmarrjes të përdorë një qasje gjithë përfshirëse sidomos për komunitetin jo shumicë duke i ndarë vende përtej prezencës së komuniteteve të caktuara në vendvotimet e ndryshme apo numrin e votave, e në këtë rast edhe të subjekti politik, Nova Deokratska Stranka- NDS.

Parashtruesi i përgjigjes në ankesë thekson se subjekti politik Nova Deokratska Stranka- NDS lidhur me vendimin e KQZ-së nr.01/85- 2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Ekipeve të Numërimit në QKN-së dhe vendimin KQZ-së, nr.01/84-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025, është njoftuar nga Sekretariati i KQZ-së me datën 14.01.2025 në ora 16:21, përmes e-mailit, për shtyrjen e aftit të dorëzimit të nominimeve nga subjektet politik për anëtar të KVV-ve dhe emailit me datën 14.01.2025, nga ora 18:12 është njoftuar me vendimin e KQZ-së nr.01/85-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Ekipeve të Numërimit në QKN-së dhe vendimin e KQZ-së, nr.01/84-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025.

Tutje parashtruesi i përgjigjes në ankesë thekson nenin 77 paragrafi 5 të ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës thekson *"Kundër vendimit të KQZ-së për mos emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të këshillave të vendvotimit, subjektet politike dhe palët tjera me interes juridik mund të parashtrojnë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e vendimit nga KQZ. Ankesa shqyrtohet dhe vendoset nga PZAP brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga parashtrimi i saj"*. Prandaj, bazuar në nenin e lartë cekur, ankesa e parashtruar në PZAP nga Nova Deokratska Stranka- NDS me numër 71/2 në ora 11:17, datë 20.01.2025, në kopje fizike përmes arkivës si dhe kërkesës së PZAP drejtuar KQZ-së për përgjigje me datën 20.01.2025, Nr. 07/6- 148/2025, lidhur me kërkesën në A.nr.71/2025, të datës 20.01.2025, është e pas afatshme dhe kërkojmë nga PZAP, që të hudhët si të pa lejuar.

Në përgjigje në ankesë si provë ka bashkangjitur një email se e ka njoftuar subjektin politik për Vendimin për miratimin e KVV në Vendvotimet e rregullta dhe me kusht dhe Vendimi për miratimin e ekipeve të numërimit në QKN.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së apelit, gjeti se:

**Ankesa është e pasafatshme**

Paneli pas vlerësimit paraprak të ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Nova Demokratska Stranka-NDS, me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së, me Nr.01/84-2025, për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, të datës 14.01.2025, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën 77 par. 5 të LZP-së, ku përcaktohet: “Kundër vendimit të KQZ-së për mos emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të këshillave të vendvotimeve, subjektet politike dhe palët tjera me interes juridik mund të parashtrojnë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e vendimit nga KQZ-ja....”.

Në këtë rast KQZ-ja, me datën 14.01.2025, ka vendosur me vendimin nr.01/85-2025 për Përbërjen e Ekipeve të Numërimit në QKN-së dhe vendimin nr.01/84-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025, dhe në po të njëjtën datë pra me 14.01.2025 janë shpallur këto vendime dhe janë njoftuar palët në këtë rast është njoftuar edhe parashtruesi i ankesës me email, ndërsa ankesa kundër vendimit Vendimit 01/84-2025 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës të datës 14 janar 2025, është paraqitur në PZAP me datë 20.01.2025, që rezulton të jetë paraqitur pas afatit ligjor pasi që afati ligjor për paraqitje të ankesës bazuar në dispozitën ligjore të nenit 77 paragrafi 5 të LZP-së është dyzet e tetë (48) orë nga shpallja e vendimit të KQZ-së.

Paneli gjeti se i njëjti është i ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 77 paragrafi 5 dhe 115 paragrafi 1, të LZP-së, si dhe në kuptim të nenit 9 paragrafi 5 nen paragrafi 5.5 i rregullës 01/2024 Rregullat dhe Procedurat e Parashtrimit dhe Vendorsjes së Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Anr.71/2025 më datën 22.01.2025

Kryesuese e Panelit  
Hajriz Hoti



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.